

Përdorimi i burimeve të caktuara në mënyrë hyjnore.

Një mësim i mëparshëm paraqiti Adrin, i cili bëri pyetjen: “Nëse vërtet ka një Perëndi të dashur, përse Ai duhet t’i lejojë njerëzit që të vuajnë? Për të praktikuar kërkimin e së vërtetës nga burimet e caktuara në mënyrë hyjnore, shpenzo disa minuta për të përfunduar së paku dy nga veprimtaritë vijuese. Shënoje atë që mëson në ditarin tënd të studimit.

1. Prindërit dhe udhëheqësit e Kishës: Dërgoja pyetjen e Adrit një prindi ose udhëheqësi të Kishës me mesazh në celular dhe shpjegoji që po e diskuton pyetjen në seminar dhe dëshiron të dish se ç’mendon ai ose ajo rreth saj.
2. Lutja: Në një lutje të heshtur personale, kërkoi Zotit udhërrëfim dhe frymëzim nga Fryma e Shenjtë për këtë pyetje. Shënoji mendimet dhe ndjenjat që të vijnë.
3. Shkrimet e shenjta: Gjej shkrime të shenjta që mund ta ndihmojnë Adrin. Për shembull, mund të lexosh rreth popullit të Almës në Librin e Mormonit që përjetoi vuajtjen e robërisë fizike (shih te Mosia 23:21–23; 24:8–15).
4. Profetët e Zotit: Gjej një thënie profetike që mund ta ndihmojë Adrin. Për shembull, lexoje thënien vijuese nga Plaku Jozef B. Uirthlin (1917–2008), i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve:



“Të mësosh të durosh periudhat e zhgënjimit, vuajtjes dhe hidhërimit është pjesë e punës sonë stërvitore. Këto përvoja, ndërsa janë shpesh të vështira të durohen në atë kohë, janë pikërisht lloji i përvojave që zgjerojnë kuptimin tonë, ndërtojnë karakterin tonë dhe rritin dhembshurinë tonë për të tjerët.

Për shkak se Jezu Krishti vuajti së tepërmi, Ai i kupton vuajtjet tona. Ai e kupton brengën tonë. Ne përjetojmë gjëra të vështira në mënyrë që edhe ne të mund të kemi një dhembshuri dhe mirëkuptim më të madh për të tjerët.” (Jozef B. Uirthlin, “Le të Ndodhë Ç’të Ndodhë, Duaje Atë,” *Liahona*, nëntor 2008, f. 27)

- Çfarë të mësuan këto burime që do të doje t’ia tregoje Adrit?

- Çfarë ke mësuar që do të sjellë ndryshim te mënyra se si kërkon përgjigje për pyetjet e vështira?